



Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Prudato Received / Delivery	06.07.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstva Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAVSHUK	3965/2022		117



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.490/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.490/2022 të datës 30.05.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati me adresë Rruga kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti i Menaxhimit të Zyrtarëve Publik në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 06.07.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.490/2022 e datës 30.05.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi Nr.888/2022 i datës 27.05.2022 i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- III. Obligohet Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit, duke e sistemuar ankuesin në një pozitë të mesme drejtuese në Shërbimin Civil në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- IV. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme që t'ia kompensoj të gjitha pagat nga data 18.01.2022 deri në zbatim të këtij vendimi, për pozitë të kategorisë së mesme drejtuese.

V. **Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi sipas pikës III dhe IV të dispozitivit.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### **A r s y e t i m**

Ankuesi me datë 30.05.2022 përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar avokatit ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3147/2022 të regjistruar me numër A.nr.490/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.888/2022 i datës 27.05.2022 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, përmes të cilit vendim ankuesit i është refuzuar kërkesa për sistemim në pozitë të nivelit të mesëm drejtues në Shërbimin Civil.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e vendimmarrjes në lidhje me këtë ankesë ka administruar këto prova:** Ankesën e ankuesit me numër të protokollit 3147/2022 e datës 30.05.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr.888/2022 i datës 27.05.2022 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme; Ankesën me numër A.nr.2202022 me numër të protokollit 1085/2022 të parashtruar nga ankuesi përmes avokatit me datën 10.03.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 26.11.2021; Vendimi A.nr.976/2021 i datës 10.01.2022 me numër protokollit 44/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 18.01.2022 me nr.131 për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; Sqarim i datës 25.02.2022 nga DMZP; E-mail zyrtar i datës 25.02.2022; E-mail zyrtar i datës 08.05.2022; E-mail zyrtar i datës 26.02.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale që janë dorëzuar nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e bazuar, sepse:**

Bazuar në provat e lëndës gjegjësisht Vendimit me nr.07/67 të datës 26.02.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vazhdimin e mandatit të në pozitën Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut, rezulton se ankuesi ka qenë i punësuar me afat të caktuar në vendin e punës të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Tregut, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Ndërsa përmes vendimit Nr.31/45 të datës 24/11/2021 të Qeverisë së Kosovës është shfuqizuar vendimi nr.07/67 i datës 26/02/2021 me arsyetimin se vazhdimi i mandatit të tretë është bërë pa bazë ligjore sipas paragrafit 4 të nenit 42 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi me datë 18.01.2022 i është drejtuar njësisë përgjegjëse, gjegjësisht Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me kërkesën Nr.protokoli.131, për sistemimin e tij në pozitë të



nivelit të mesëm drejtues ashtu si parashihet në nenin 42 paragrafi 7 dhe 8 i Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114 ,Ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në raport me kërkesën e ankuesit asnjëherë nuk kishte nxjerr akt administrativ në lidhje me kërkesën për sistemim konformë legjislacionit në fuqi të zyrtarëve publik, andaj ankuesi me datë 10.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli me datë 06.05.2022 ka nxjerr Vendimin A.nr.220/2021 dhe ka obliguar Drejtorin e DMZP-së që të trajtojë kërkesën e ankuesit dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me kompetencat e përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Zyrtaret Publik.

Me datë 27.05.2022, Zëvendësuesi i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publike, ka nxjerr Vendimin Nr.888/2022 me të cilin ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e ankuesit të datës 18.01.2022 për emërim në pozitë të mesme drejtuese, me arsyetimin se me asnjë dispozitë të Ligjit për Zyrtaret Publikë nuk përcaktohet përfundimi i mandatit para kohe dhe DMZP-ja nuk ka kompetencë për të vendosur për sistemim të ankuesit në ndonjë nga pozitat e nivelit të mesëm drejtues pasi që nuk kemi të bëjmë me përfundim të mandatit rregullt siç përcaktohet me dispozitat e paragrafit 7 dhe 8 të nenit 42 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.888/2022 të datës 27.05.2022 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, pretendon që ky vendim është nxjerr jashtë kërkesave ligjore të parashtruar në kërkesën e datës 18/01/2022 si dhe përmbajtja është mbi bazën e shmangies së obligimeve dhe udhëzimeve që kanë rrjedhë nga vendimi Nr.220/2022 të datës 06/05/2022 të KPMSHCK-së, që këtë vendim të DMZP-së e bëjnë të padrejtë dhe të paligjshëm, nga se nuk ka arrit të trajtoj pretendimet e ngritura me iniciimin e ri të procedimit administrativë nga ankuesi, pasi pretendimi i ankuesit ka qenë sistemimi në pozitë të nivelit të mesëm drejtues sipas dispozitave që parashohin dispozitat e ligjit të zyrtarëve publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, fillimisht analizojë dispozitat ligjore lidhur me kompetencat e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, dhe rrjedhimisht duke iu referuar nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6, nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.16 dhe nenin 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, konstatoi se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë si njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore është kompetent për emërimin e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues të cilëve ju mbaron mandati, fillimisht në një pozitë të nivelit të mesëm drejtues dhe pastaj në pozitë të kategorisë së lartë profesionale.

Ndërsa lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, shqyrtoj Vendimin Nr.888/2022 të datës 27.05.2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe si rrjedhojë ka konstatuar që ky vendim është nxjerr pa ndonjë arsyetim të gjendjes faktike dhe juridike në lidhje me rastin konkretë, mbi bazë të kërkesës së ankuesit, sepse ankuesi në kërkesën e tij të datës 18.01.2022, ka kërkuar që të emërohet në një në pozitë të nivelit të mesëm drejtues ashtu si e parashohin dispozitat e Ligjit të Zyrtarëve Publik, pas përfundimit të mandatit në ndonjë pozitë të nivelit të lartë drejtues, ndërsa vendimi i DMZP-së bazohet në çështje që nuk përkasin me

kërkesën e ankuesit si dhe në arsyetim të këtij vendimi potencohen çështje që llogariten çështje të gjykuara sipas vendimit të institucioneve kompetente në këtë rast KPMSHCK-së, nga se në asnjë vendim të këshillit nuk është konstatuar fakti se ankuesi e ka humbur statusin e nëpunësit civil përkundër shkarkimit që i është bërë me datë 24/11/2021 përmes vendimit Nr.31/45 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ndërlidhur me vendimin Nr.888 të datës 27/05/2022 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB të lëshuar nga Zv. Drejtoresha për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik thekson faktin se përmbajtja e dispozitivit dhe arsyetimit të vendimit të atakuar të pasqyruar si më lartë në këtë vendim, bie ndesh me dispozitat ligjore të përcaktuara si në nenin 83 paragrafin 1 ku përcaktohet se: "Nëpunësi civil në marrëdhënie pune në Shërbimin Civil, në pajtim me Ligjin e Shërbimit Civil (03/L-149) dhe që mban një pozitë ekuivalente me pozitën e nëpunësve civilë sa i përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës civil sipas nenit 2, paragrafi 3 të këtij ligji, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji" pasi që sipas vendimit të atakuar përmes kësaj ankese, statusi i garantuar i nëpunësit civil sipas kësaj dispozita ligjore i humbet, madje përmbajtja e vendimit të atakuar bie ndesh me nenin 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paañsisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë", nga se ankuesit sipas vendimit të atakuar me këtë ankesë i cenohet e drejta e ruajtjes së statusit të fituar të nëpunësit civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se përmes vendimit të këshillit A.nr.220/2022 të datës 06/05/2022 është qartësuar situata sa i përket çështjes së statusit të nëpunësit civil dhe at po citojmë pjesën e vendimit në faqen 4 të tij; "Në këtë rast meqë ankuesit i ka përfunduar mandati i dytë më datë 22/03/2021 ashtu si ka qenë i specifikuar përmes vendimit Nr.04/37 të datës 23/03/2018 dhe pasi këshilli përmes vendimit A.nr.976/2021 ka konstatuar se vazhdimi i mandatit të tretë nuk ka qenë në harmoni me legjislacionin në fuqi të shërbimit civil, atëherë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesit nuk i ka humbur e drejta për sistemin konformë legjislacionit të shërbimit civil që është në fuqi për arsye që mandati i tretë nuk ka ardhur si rezultat i kërkesave të ankuesit por i njëjti ka ardhur si rezultat i vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës si institucion shtetëror kompetentë , dhe pasi vazhdimi i mandatit të tretë përmes vendimit Nr.07/67,të datës 26/02/2021 është konstatuar se ka qenë i kundërligjshëm, atëherë duhet pasur parasysh faktin që me përfundimin e mandatit të dytë kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë aplikohen dispozitat e nenit 42 paragrafi 7 dhe 8 të këtij ligji, i cili përcakton se: "7.Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale" dhe "8.Deri në emërimin në një pozitë, sipas paragrafit 7 të këtij neni, nëpunësi vazhdon të gëzojë të drejtën e pagës për pozitën e nivelit të lartë drejtues për një periudhë 3 mujore. Refuzimi për t'u emëruar në pozitën e nivelit të mesëm drejtues ose profesional, të caktuar nga Njësia e Pranimit, liron nëpunësin nga Shërbimi Civil", dhe dispozitat e nenit 15 paragrafi 1 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: "1.Pas përfundimit të mandatit të nëpunësit, DMZP për institucionet e administratës

shtetërore dhe NJBNJ për institucionet tjera shtetërore e emëron nëpunësin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit më të lartë të kategorisë profesionale...” rrjedhimisht nga përmbajtja e vendimit të këshillit A.nr.220/2022 të datës 06/05/2022 i cili është vendim administrativ i formës së prerë konformë nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është vendosur sa i përket dilemës se a e ka humbë statusin e nëpunësit civil ankuesi apo jo, pra përfundimi sipas këtij vendimi që është i formës së prerë është se ankuesit nuk i ka humbë statusi i nëpunësit të shërbimit civil përkundër shkarkimit përmes vendimit Nr.31/45 të datës 24/11/2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe se mbi këtë bazë ka qenë obligimi i DMZP-së që të sistemoj në ndonjë pozitë konformë Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik respektivisht nenit 42 paragrafit 7 dhe 8 të këtij Ligji, andaj mbi këtë bazë të specifikuar më lartë vendimi Nr.888/2022 i datës 27.05.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i Ministrisë së Punëve të Brendshme është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të potencuar më lartë në këtë pjesë të arsyetimit të këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, mbi bazë të asaj që specifikua më lartë konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike dhe se ka rezultuar edhe me aplikim të gabuar të së drejtës materiale sa i përket kësaj çështje respektivisht përfundimit të mandatit në shërbimin civil, sepse në kapitullin pestë (V) të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rregullohet çështja e përfundimit të marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, ndërsa me nenin 59 të këtij ligji, përcaktohen në mënyrë taksative mënyrat e përfundimit të marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, duke përcaktuar se: “1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil, përfundon si në vijim: 1.1. për shkaqet e përcaktuara në neni 60 të këtij ligji; 1.2. me lirimin nga Shërbimi Civil sipas neneve 61 dhe 62 të këtij ligji; dhe 1.3. largimi nga Shërbimi Civil, si masë disiplinore në përputhje me këtë ligj”, në rastin konkret të ankuesit nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet ligjore për përfundim të marrëdhënies së punës, sepse themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji siç parashihet me nenin 32 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se meqenëse nuk janë konsumuar asnjë nga kushtet ligjore të përcaktuara me legjislacionin për zyrtarët publik për përfundimin e mandatit të ankuesit në shërbimin civil nga arsyet e specifikuara më lartë, konstaton se në këtë rast aplikohen dispozitat e nenit 42 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “Me mbarimin e mandatit sipas paragrafit 4 apo 5 të këtij neni, për kandidatët e emëruar në kategorinë e nivelit drejtues nga Shërbimi Civil, Njësia e Pranimit detyrohet të emërojë nëpunësin të cilit i mbaron mandati në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese dhe pastaj në pozitë të kategorisë profesionale” dhe dispozitat e nenit 15 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, i cili përcakton se: “Pas përfundimit të mandatit të nëpunësit të nivelit të lartë drejtues nga shërbimi civil, Departamenti për menaxhimin e zyrtarëve publikë për institucionet e administratës shtetërore dhe NJBNJ për institucionet tjera shtetërore është e obliguar që brenda afatit më të shkurtër kohor, të emërojë nëpunësin në një pozitë të kategorisë së mesme drejtuese nëse ka të lirë një pozitë të tillë, e nëse nuk ka të lirë atëherë e emëron në një pozitë të nivelit profesional”.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese duke u bazuar edhe në pretendimin e ankuesit edhe në këtë ankesë sikur edhe në vendimin A.nr.220/2022 të datës 06/05/2022 konstaton se ndërlidhja e aktit të shfuqizuar Nr.07/67, datë 26/02/2021 me dispozitat e Ligjit Nr.05./L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 53 paragrafi 2 është i domosdoshëm me rastin e trajtimit të kërkesës nga DMZP-ja, nga se shfuqizimi konformë kësaj dispozite të këtij ligji prodhon pasoja juridike për të ardhmen e jo në mënyrë retroaktive ,andaj mbi këtë bazë me qenë se në këtë periudhë të shfuqizimit të këtij vendimi(Nr.31/45 të datës 24/11/2021)ka qenë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për zyrtarët publik, atëherë DMZP-ja me rastin e trajtimit të kërkesës së datës 18.01.2022,domosdoshmërishtë duhet të ketë parasysh dispozitat e nenit 42 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për zyrtarët publik, ky kishte qenë edhe obligim ligjor nga DMZP-ja, me rastin e trajtimit të kërkesës së datës 18/01/2022 edhe sipas vendimit A.nr.220/2022 të datës 06/05/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, sipas vlerësimit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, Vendimi Nr.888/2022 i datës 27.05.2022 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk përmban një trajtim meritore të çështjes kryesore që rrjedhë sipas kërkesës së datës 18.01.2022 që është objekt i kësaj ankese përkundër që vendimi A.nr.220/2022 të datës 06/05/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kishte definuar çështjen e statusit të ankuesit dhe kishte udhëzuar atëherë DMZP-në që me rastin e trajtimit të kërkesës së datës 18.01.2022, domosdoshmërishtë duhet të ketë parasysh dispozitat e nenit 42 paragrafi 7 dhe 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për zyrtarët publik, rrjedhimisht ky vendim është në kundërshtim me frymën e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe i njëjti është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.7 dhe nenit 53 paragrafi 2 të këtij ligji, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit për sistemim konformë dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i bazuar mbi bazë të dispozitave të specifikuar më lartë.

Duke marr parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, është i obliguar që ankuesin ta sistemoj në një pozitë të mesme drejtuese në shërbimin civil në pajtim me këtë vendim dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kompensimin e pagave, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se meqë ankuesi më datë 18.01.2022 ka parashtruar kërkesë tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, për sistemim në një pozitë të mesme drejtuese, meqenëse Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nuk ka sistemuar ankuesin në pajtim me legjislacionin në fuqi, atëherë sipas kësaj edhe barra e pagesës i bie këtij institucioni, si rrjedhojë Kolegji, konstaton se ankuesit duhet t'i kompensohet paga nga data 18.01.2022 në momentin kur ka parashtruar kërkesë tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve publikë deri në zbatimin e këtij vendimi, për pozitë të kategorisë së mesme drejtuese.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda, A.nr.490/2022, datë 06.07.2022**

**Sabile AVDYLI**



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- ❖ Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, avokatit
- ❖ Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë;
- ❖ Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së;